



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



VENDIMET E BORDIT TË DATËS 01.10.2019

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) në mbledhjen e mbajtur më 01.10.2019 në Prishtinë ka shqyrtuar disa çështje aktuale në basketbollin kosovar dhe ndër të tjera ka marr këto vendime:

REND DITE:

1. E ka miratuar Raportin e Punës dhe Raportin Financiar të FIBA U20 Kampionatit Evropian, Divizioni B - Femrat;
2. I ka miratuar Raportet e Punës për ndeshjet e organizuara si nikoqir të Përfaqësueses A të Kosovës dhe të Superkupës së Kosovës;
3. E ka miratuar Raportin Financiar të FBK-së të përgatitur deri më datën 30.09.2019;
4. E ka miratuar projektin për mbështetje të Superligës së Femrave, Ligës së Parë të Femrave, Ligës U14 dhe Ligës U16 të Femrave;
5. E ka trajtuar çështjen e pjesëmarrjes së Përfaqësueseve të Reja të Kosovës në FIBA Kampionate Evropiane, si dhe mundësinë për të aplikuar për organizimin e një Kampionati Evropian të gjeneratave të reja. Për këtë çështje, Bordi do të vendos në ditët në vijim;
6. E ka miratuar pjesërisht kërkesën e KBF Prishtina për mbështetje për pjesëmarrjen e parë të një klubi të femrave në garat zyrtare të FIBA-s, siç është FIBA Europe Cup Women në edicionin 2019/20;
7. E ka miratur kërkesën e KB Peja për të luajtur në Ligën Ballkanike;
8. Nuk e ka miratuar kërkesën e KB Rahoveci për heqje të dënimit, pasi Bordi i FBK-së nuk ka bazë ligjore për ta trajtuar këtë kërkesë.

Sinqerisht,
Arben Fetahu
Kryetar



Kosovo Basketball Federation, Lagjja "Arbëria", Bloku C3/(Faza 2), Rr. Radovan Zogoviq, Hyrja 7 10000 Prishtinë,
Kosovë

ëëë.basketbolli.com, email: federata@basketbolli.com, mob: +386 49 738 080



TEB



RUGOVE



bakertilly



Spitali Amerikan



Kutia